



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1963, datë 31.05.2012

Për

“Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1884, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Albtelecom sh.a.””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 31.05.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimi i ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1884, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Albtelecom sh.a.”.

BAZA LIGJORE:

- Pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 9918);
- Neni 137, e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);

- Pika 17, e nenit 21 të “*Rregullores së Brendshme të AKEP*”, miratuar me Vendim nr. 170, datë 24.04.2004 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138, të Ligjit nr. 9918;
- Rregullore “*Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar*”;
- Rregullore nr. 24 datë 02.02.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP “*Për Autorizimin e Përgjithshëm*” miratuar me VKD Nr.1774, datë 02.02.2012”.
- Rregullore nr. 13 datë 16.04.2010 për “*Portabilitetin e Numrit*” (e ndryshuar), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, Datë 07.04.2010”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresën me nr. 162 Prot., datë 9.5.2012, (nr. 560 Prot. i AKEP, datë 10.53.2012) e sipërmarrësit Neofone sh.p.k, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 1884, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP për “Disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Altelecom sh.a..”*,”
- Vendimit nr. 1884, datë 19.4.2012,, të Këshillit Drejtues të AKEP, “*Disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Altelecom sh.a..”*.”
- Projektvendimin mbi shqyrtimin e ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1884, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP për “*Disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Altelecom sh.a..”*,”
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Neofone sh.p.k. me anë të këtij ankimimi shprehet se ndryshimet dhe shtesat në ORI-n e Altelecom sh.a., të miratuara me VKD nr. 1884, datë 19.4.2012, duhet të bazohen në ligjin nr. 9918, si dhe në praktikat me të mira europiane. Gjithashtu AKEP nuk ka miratuar në tërësi ORI-n e publikuar të Altelecom i cili ka disa pika në kundërshtim me kuadrin rregullator në Republikën e Shqipërisë.

- a. Për pikën 4, të aneksit të ndryshimeve të miratuara, Neofone shprehet se përdorimi i kapaciteteve ekskluzive për shërbimin 102 është jo në respekt të uljes së kostove për operatorët si dhe përdorimin e kapaciteteve të interkoneksionit në mënyrë eficiente. Operatorët FNT gjithmonë kanë ngritur pretendime se nuk kanë kapacitete të lira për lidhjen me operatorë të rinj si dhe për shtimin e kapaciteteve për operatorët ekzistues. Ky

përcaktim do të ishte i nevojshëm nëse operatorët FNT do të vendosnin në dispozicion një pikë tjetër interkoneksioni për shërbimin 102 të ndryshme nga 101, sic edhe praktikata europiane mësojnë. Nuk ka asnjë praktikë europiane që në të njëjtën pikë interkoneksioni të ndajë trafikun kombëtar nga ai me origjinë ndërkombëtare. Ky përcaktim do sjellë abuzim nga operatorët FNT të cilët në asnjë rast nuk kanë deklaruar kapacitete të lira dhe të disponueshme në respekt të kuadrit rregullator dhe nuk do të jepnin interkoneksion me argumentin e pavërtetë se nuk kanë kapacitete të lira.

- b. Për pikën 6, të ankesit të ndryshimeve të miratuara, duhet të shohen fjalët “...me negociata dypalëshe sipas dispozitave të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 ‘Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë’” duke zbatuar rigorozisht VKD nr. 1742, datë 20.12.2011, ku AKEP shprehet: ii. *Objekt negociatash komerciale për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.* Mospërcaktimi i saktë ashtu si vetë AKEP është shprehur, do të sillte mosmarrëveshje dhe keqinterpretime nga të gjitha palët.
- c. Për pikën 2, nënpika 2/1 e nenit 9 ku kërkohet tabela e rrugëzimit të trafikut ndërkombëtar, është e paqartë dhe krijon keqinterpretim nga ana e operatorëve FNT. AKEP duhet të shtojë se Albtelecom është i detyruar të jap dy pika interkoneksioni për trafikun me origjinë ndërkombëtare duke siguruar kështu një SLA shumë të lartë për këtë trafik megjithëse ky është një diskriminim për trafikun me origjinë kombëtare. Gjithashtu kjo pikë është e panevojshme pasi nga viti 2008, operatorët kanë punuar me një rrugëzim dhe nga ana e OFNT nuk ka patur ankesa për cilësinë e shërbimit me operatorët alternativë. Këtë pikë edhe vetë operatorët nuk e përmbushin pasi nuk kanë dy rrugëzime me të gjithë operatorët që kanë MI. Sipas Neofone, AKEP, duhet të investigojë për këtë pikë pasi kjo kërkohet vetëm për operatorët alternativë dhe vetëm për trafikun ndërkombëtar. AKEP duhet të kërkojë përmbushjen e këtij detyrimi edhe për trafikun kombëtar pasi ka detyrimin për mbrojtjen e abonenteve shqiptar dhe arritjen e një niveli cilësie shumë të lartë. AKEP duhet të sqarojë se c’farë nënkuptohet me këtë detyrim që u vendoset vetëm operatorëve alternativë e jo FNT.
- d. Për pikën 2, nënpika 2/1, e nenit 9 ku kërkohet të paraqitet ISPC si dhe një kontratë me një operator të huaj është abuzive dhe antikonkurruese. ISPC është përcaktuar nga AKEP dhe është një detyrim për të ofruar shërbimin e tranzitimit ndërkombëtar, kështu që në qoftëse një operator kërkon këtë shërbim patjetër që është pajisur me ISPC. Paraqitja e kontratës me operatorin ndërkombëtar është kundër ruajtjes së konfidencialitetit dhe është në kundërshtim me rregullat e ruajtjes së sekretit tregtar (neni 18, ligji nr. 9901). Neofone, këtë pikë e quajmë të panevojshme, pasi nuk ka asnjë qëllim në mbarëvajtjen e interkoneksionit midis Albtelecom dhe operatorëve të tjerë.
- e. Për pikën 1 nënpika 5/k dhe për pikën 2 nënpika 2/1, ku kërkohet historiku i trafikut të dorëzuar në AKEP, Neofone mendon se është e panevojshme, pasi për një operator ekzistues Albtelecom i ka këto statistika të cilat shkëmbehen çdo muaj në bazë të MI. Për një operator të ri nuk mund të plotësohen pasi nuk ka deklaruar në AKEP. Është e paqartë se kur duhet të jepen këto të dhëna, në çfarë intervali. Gjithshtu, nuk del e qartë se cili është përfitimi i Albtelecom nga këto të dhëna. Të gjithë operatorët janë të detyruar të paraqesin këtë informacion në AKEP dy herë në vit. Nëse AKEP mendon se ky është element shumë i rëndësishëm që i duhet mbarëvajtjes së marrëveshjes së interkoneksionit midis dy operatorëve në Republikën e Shqipërisë, në cdo moment mund t’i vendosë këto të dhëna në dispozicion të OFNT-ve.

- f. Për pikën 2, nënpika 2/1, dhe nënpika 2/2, ku kërkohen masat e marra për aksesin në shërbimet e emergjencës, AKEP në këtë pikë përmend se ky detyrim rrjedh nga “Rregullorja për Autorizimin e Përgjithshëm”. Duke iu referuar kësaj, të gjithë operatorët që janë pajisur me konfirmimin e autorizimit të përgjithshëm e kanë paraqitur këtë informacion në AKEP dhe ju është pranuar nga AKEP. Kjo pikë le vend për abuzim pasi nuk është specifikuar se kush do ta verifikojë këtë informacion të dhënë OFNT Albtelecom. Në të gjitha rastet OFNT mund të mos pranojnë këto masa dhe mund të ngrenë pretendime të cilat do të sjellin mosmarrëveshje. AKEP me rregulloret e miratuara i ka sanksionuar se c’farë duhet të përmbushin operatorët në R.SH. për të operuar në tregun e komunikimeve elektronike. Në asnjë moment nuk mund t’i lihet përgjegjësia OFNT-ve për interpretimin e dokumentave apo investimet e kryera nga operatorët alternativë.
- g. Në pikën 1, nënpika 5/k dhe në pikën 2, nënpika 2/1, ku kërkohet numri i abonetëve është përsëri abuzive dhe antikonkurrese. Në bazë të nenit 18, ligji nr. 9901, shprehet qartë se kur duhet të jepet një informacion i tillë tek palët e tjera. Kjo kërkesë është e panevojshme pasi nuk ka anjë qëllim për mbarëvajtjen e interkoneksionit midis Albtelecom dhe operatorëve të tjerë.

Neofone shprehet se AKEP, me miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në RIO duhet të merrte parasysh mendimet e operatorëve të tjerë në treg pasi ata preken drejtpërdrejt. Këto ndryshime duhet të reflektojnë edhe kërkesat e operatorëve të tjerë jo vetëm të FNT.

Në përfundim të pretendimeve sa më sipër, Neofone kërkon:

- a. pika 4 të hiqet plotësisht ose të vendoset detyrimi për lidhje në një pikë tjetër interkoneksioni e dedikuar për trafikun kombëtar;
- b. pika 6, të ndryshohet duke vendosur: *“Tarifë objekt negociatash komerciale sipas dispozitave të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Albtelecom ka të drejtën e ndryshimit për tarifën e shërbimeve të interkoneksionit në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9918 dhe kuadrin rregullator përkatës. Tarifën e ndryshuara duhet të publikohen e t’i bëhen të ditura operatorit përfitues pas njoftimit paraprak dhe miratimit nga AKEP. Për tarifën e publikuara në këtë MI dhe që nuk janë objekt rregullimi nga AKEP, Albtelecom ka të drejtë t’i ndryshojë duke bërë publikimin në ofertë dhe njoftuar operatorin përfitues të paktën 3 muaj para hyrjes në fuqi të tarifës së re. Në rast se operatori përfitues nuk është dakord me tarifën e re ai ka të drejtë të ankohet në AKEP, jo me vone se dy muaj nga marrja e njoftimit për zgjidhje mosmarrëveshje”*;
- c. në pikën 2, nënpika 2/1, e nenit 9, ku kërkohet tabelat rrugëzimit të trafikut ndërkombëtar, të hiqet plotësisht;
- d. në pikën 2, nënpika 2/1, e nenit 9, ku kërkohet të paraqitet ISPC si dhe një kontratë me një operator të huaj, të hiqet plotësisht;
- e. në pikën 1 nënpika 5/k dhe për pikën 2 nënpika 2/1, ku kërkohet historiku i trafikut të dorëzuar në AKEP, të hiqet plotësisht;
- f. në pikën 1, nënpika 5/k dhe në pikën 2, nënpika 2/1, ku kërkohet numri i abonetëve: të hiqet plotësisht.

- I. AKEP për sa i përket pretendimeve të ngritura në ankimimin administrativ të sipërmarrësit Neofone sh.p.k., arsyeton si më poshtë:
- a. Në lidhje me pretendimin e Neofone për pikën 4, AKEP gjykon se administrimi i trafikut në qarqe të ndryshme E1 sipas trafikut kombëtar dhe ndërkombëtar, i shërben më mirë rritjes së cilësisë së shërbimit si dhe shmang shkëputjet e mundshme të terminimit të trafikut kombëtar në rast të problemeve me trafikun ndërkombëtar.
 - b. Për pikën 6, formulimi i miratuar nga AKEP është në linjë me Vendimin nr. 1742 datë 20.12.2011.
 - c. Përcaktimet e pikave 1 dhe 9 të cilat kërkohen të hiqen nga Neofone nuk përbëjnë detyrime të tepërta dhe janë në linjë me Rregulloren “Per Autorizimin e Pergjithshem” miratuar me VKD nr. 1774, date 02.02.2012, Rregulloren Per Administrimin e Kodeve të Pikave të Sinjalizimit Kombëtar (NSPC) dhe Ndërkombëtar (ISPC) për Interkoneksionin e Rrjeteve, miratuar me Vendimin Nr.1257, datë 16. 04. 2010 te Keshillit Drejtues të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 137 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17, të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Rrëzimin e ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k me nr. nr. 159 Prot., datë 9.5.2012, *për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 1884, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP për “Disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Albtelecom sh.a..”*;
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1884, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP për *“Disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Albtelecom sh.a..”*;
3. Të njoftohet Neofone sh.p.k. për zbatimin e këtij Vendimi;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**